



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë - Albania,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 533/7 Prot.

Tiranë, më 10 . 09 . 2015

V E N D I M

Nr. 1 , datë 10 . 09 . 2015

“Për pezullimin e procesit të verifikimit të rastit të *** , ***** dhe ***** , punonjës pranë Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë”**

Me urdhrin nr. 533/1, prot, datë 31.07.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar procesin e verifikimit të rastit të ***** dhe ***** , punonjës pranë Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë, lidhur mbi transferimin e tyre nga Drejtoria e Bujqësisë Tiranë tek Agjencia e Zhvillimit Bujqësor Rural në kuadër të ristrukturimit dhe riorganizimit të institucionit. Këtij urdhri i është bashkëngjitur për verifikim edhe rasti i punonjësit ***** (nr. 533/5 prot., dt. 12.08.2015), i cili gjithashtu, pretendon se është cënuar pa të drejtë nga procesi i ristrukturimit.

Në vijim, me shkresën nr. 3824/1, datë 20.08.2015, “*Kthim përgjigje tuajës nr.533/4 të datës 31.07.2015*”, Departamenti të Administratës Publike, ka njoftuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, se pasi ka administruar propozimin e Komisionit të Ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë për transferimin e përhershëm të disa punonjësve për shkak ristrukturimit, ka konstatuar disa parregullsi në zbatimin e ligjit dhe ka filluar rishqyrtimin e procesit.

Nga sa më sipër, konstatohet se njësia përgjegjëse është duke vlerësuar propozimin e Komisionit të Ristrukturimit të Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë për transferimin e përhershëm të disa punonjësve si pasojë e ristrukturimit të këtij institucioni, ku përfshihen edhe tre punonjësit e mësipërm. Në këto kushte, çmoj se procesi i verifikimit, nisur me urdhrin nr. 533/1, dt. 31.07.2015, duhet të pezullohet deri në përfundimin e procedurës së rishqyrtimit dhe rivlerësimit të propozimeve të Komisionit të Ristrukturimit nga ana e kësaj njësie.

Për këto arsye:

Bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe nenit 78, të ligjit nr. 8485, dt. 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të RSH",

V E N D O S A:

1. Të pezulloj procesin e verifikimit të informacionit të ardhur nga ***** ,
***** dhe ***** , punonjës pranë Drejtorisë së Bujqësisë Tiranë,
deri në përfundimin e procedurës së rishqyrtimit dhe rivlerësimit nga ana e Departamentit
të Administratës Publike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA